



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 016/01-40967, dt, 29 Qershor 2026.

Në bazë të nenit 12 par.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 në mbështetje të nenit 17 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenit 17 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Qershor 2026, merr këtë:

VENDIM

Nr. 76/2026

Mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të Zyrave të Katit të III (tretë), tek Poliklinika Stomatologjike, për ofrimin e shërbimeve Gastronomike Zona Kadastrale Pejë, të cilat janë destinuar për dhënien në shfrytëzim

1. **MIRATOHET** - Vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Komisioni vlerësues sipas këtij vendimi përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve si me poshtë:
 - 2.1. Arben Morina, anëtarë i kuvendit nga subjekti LDK, anëtarë,
 - 2.2. Edonjeta Berisha, anëtarë i kuvendit nga subjekti PDK, anëtarë,
 - 2.3. Meriton Fetaj – anëtarë nga ekzekutivi i komunës – Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
 - 2.4. Agron Nikçi – anëtar nga ekzekutivi i komunës – Drejtor në Drejtorinë për Punë Komunale dhe Shërbime Publike
 - 2.5. Vlora Mahmutaj - anëtarë nga sektori joqeveritar anëtar.
3. Kryesuesi i Komisionit vlerësues zgjidhet me shumicë votash nga rradhët e anëtarëve të Komisionit Vlerësues.
4. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit Vlerësues janë: përpilimi i njoftimi publik me të dhënat për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, prezenca në shpalljen e interesit publik, hapja e ofertave, vlerësimi final i ofertave në pajtim me kriterët e përcaktuara me njoftimin për ankand publik dhe shprehje të interesit, si dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me ligjin dhe rregullore në fuqi.
5. Dërgimi të Kryetari i Komunës për miratim të ofertës se përzgjedhur për dhënien afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës dhe çështje tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme nga Komisioni Vlerësues.
6. Administrata e Komunës i ofron përkrahje Komisionit Vlerësues për dhënies në shfrytëzim të pronës Komunale.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

8. Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT
Z. Rexhep Kurtbogaj